



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 prill 2015
Nr. ref.: V791/15

VENDIM

në

Rastin nr. KO22/15

Parashtrues

Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës

**Kërkesë për përjashtim të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të
Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, z. Sami Kurteshi.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon rishqyrtimin e Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Rastin KO155/14.
3. Në këtë kërkesë, parashtruesi gjithashtu kërkon përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 18 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), Nr. 03/L-121, dhe me rregullin 7 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 18 [Përjashtimi i gjyqtarit] të Ligjit dhe në rregullin 7 [Procedurat për përjashtim], paragrafët 2, 3 dhe 4, të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 26 shkurt 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën KO22/15, që përmbante kërkesën për përjashtim të Kryetarit të Gjykatës.
6. Më 17 prill 2015, Gjykata ndoqi procedurën e paraparë me rregullin 7.4 të Rregullores së punës, i cili parasheh si në vijim:

“[...] Gjykata, me shumicën e votave të gjyqtarëve, vendos për petitionin për përjashtim. Para marrjes së vendimit për përjashtimin e kërkuar, merret një deklaratë nga gjyqtari, përjashtimi i të cilit kërkohet dhe, nëse është nevoja, do të sigurohen edhe sqarime të tjera. Gjyqtari, përjashtimi i të cilit kërkohet, nuk mund marrë pjesë në procedurën e marrjes së vendimit. Vendimi i Gjykatës i dorëzohet palëve në procedurë”.

7. Më 17 prill 2015, Gjykata mori një deklaratë nga Kryetari i Gjykatës në pajtim me rregullin 7.4 të Rregullores së punës.
8. Të njëjtën ditë, Gjykata, pa praninë e Kryetarit të Gjykatës, shqyrtoi kërkesën e parashtruesit dhe votoi njëzëri që ta refuzojë atë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

9. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Kryetari i Gjykatës duhet të përjashtohet, ku pretendohet se *“[...] për shkak të (1) angazhimit të tij në diskutimet e brendshme të EULEX-it në lidhje me procedurën për emërimin e tre gjyqtarëve ndërkombëtarë; dhe (2) deklaratës së tij të qartë sipas të cilës anashkalimi i Kuvendit nuk do të përbënte shkelje kushtetuese në këtë rast”.*

Pranueshmëria e kërkesës

10. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar ndonjë provë apo argumente që do të tregonin se ekziston ndonjë arsye e vlefshme për përjashtimin e tij.
11. Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit është e paarsyetuar, irelevante dhe e paargumentuar.
12. Prandaj, Gjykata e refuzon kërkesën e parashtruesit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 29 të Ligjit, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) dhe në pajtim me rregullin 56 të Rregullores së punës, më 17 prill 2015, njëzëri,

VENDOS

- I. TA REFUZOJË kërkesën e parashtruesit për përjashtim të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim parashtruesit të kërkesës dhe Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas votimit.

Zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Ivan Čukalo*vić*

